Universum International College
Powered by Arizona State University

NITI DENT

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

Në mes të **Kolegjit UNI –Universum International College Powered by Arizona State University** Dhe **Niti Dent**

I.Qëllimi i Memorandumit

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike, dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

II. Fushëveprimtaria

2. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit, **Niti Dent** do t'u mundësoj sipas nevojave të kompanisë, studentëve të Programeve Shëndetësore të Kolegjit UNI vizita praktike në **Niti Dent** me kohëzgjatje dhe numër të dakorduar në mes të palëve.

3. Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, Kolegji UNI do t'u mundësoj studentëve vizitat studimore, të përcaktuar nga përgjegjësi i caktuar nga **Niti Dent** vizitat studimore që do të organizohen për studentet tanë në Kompani dhe për ndonje pajisje dhe medikamente që mund të furnizohemi nga Kompania juaj për nevojat e Kolegjit gjatë zhvillimit te studimeve pasi që jeni prodhues i shumë asortimaneve. Ne gjithashtu mund të bejmë edhe analizat e ndryshme qe ju i ofroni ne Laboratorin tuaj testues të produkteve që ju jeni të çertifikuar për këtë veprimtari.

4. **Niti Dent** mund të ftohet edhe për vizita promovuese në Kolegjin UNI, për studentët tanë dhe të gjithë të interesuarit dhe poashtu si ligjerues mysafir gjate vitit akedemik, dhe gjatë proceseve ku kërkohet prezenca juaj. Poashtu edhe pasi qe studnetat tanë do të kenë mundsine e kontaktit që në të ardhmën të vet punesohen në këtë kompani në programin e Nutricionit, dhe produktet që ju i ofroni.

III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuara sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda

përkufizimeve të përcaktuar me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjërës palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;

2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjelltë me besueshmëri të plotë;

3. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.

4. Kohëzgjatja e këtij memorandumi është pa afat kohor.

5. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga ana e palëve të përfshira në memorandum.

Prishtine, më: 16.01.2026

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji UNI – Universum

Alejtin Berisha
Drejtori Ekzekutiv

Niti Dent

Lirim Abazi
Drejtori Ekzekutiv/Menaxheri